

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, njoftimin për ndërprerjen me transmetim të programit në radio nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive për Radioaktivitet RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë (nr.y në ark.08-4808/1 datë 27.12.2023), deklaratë (e noterizuar), nr.y në ark.08-4808/2 datë 29.12.2023 nga themeluesi/pronari i vetëm i transmetuesit, UZP nr.6037/2023 datë 28.12.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.0201-125/4 datë 11.1.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 2-të mbajtur më 11.1.2024 miratoi:

Aktvendim për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive për Radioaktivitetet RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive për Radioaktivitet RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë është posedues i lejes për transmetim në radio PA1 nr.08-98 datë 7.9.2023, (me vlefshmëri nga 5.1.2024 deri më 4.1.2027), e cila transmeton program nëpërmjet radiofrekuencave, në nivel lokal në zonën e Komunës së Dellçevës.

Më datë 27.12.2023 Shoqëria Tregtare Radiodifuzive për Radioaktivitet RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë, në mënyrë elektronike në adresën zyrtare e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) dorëzoi njoftim për ndërprerje me transmetim të programit në radio nr.y në ark.08-4808/1 datë 27.12.2023, me të cilën e njoftoi Agjencinë se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive për Radioaktivitet RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë, nuk do të mund të vazhdojë punën, gjegjësisht do të ndërpresë me transmetim të programit në radio për shkak të mospërofitimit të punës në vitet e fundit, si dhe për shkak të shpërnguljes. Në lidhje me njoftimin e cituar (përmendur), Agjencia më 28.12.2023, në adresën elektronike zyrtare të transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në Regjistrin Qendror të RMV-së, ka njoftuar transmetuesin në fjalë se në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), është e nevojshme të dorëzojë deklaratë të noterizuar nga themeluesi/pronari i vetëm i transmetuesit, në të cilën duhet të theksohet se transmetuesi Shoqëria Tregtare Radiodifuzive për Radioaktivitet RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë që nga 5.1.2024, ndërpreu me transmetim të programit në radio.

Më datë 28.12.2023, në mënyrë elektronike, në adresën zyrtare të postës elektronike e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive për Radioaktivitet RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë, është dorëzuar deklaratë (e noterizuar), me nr.y në ark.08-4808/2 datë 29.12.2023 nga themeluesi/pronar i vetëm i Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive për Radioaktivitet RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë, UZP nr.6037/2023 datë 28.12.2023, i cili deklaroi se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive për Radioaktivitet RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë që nga 5.1.2024 ndërpreu me transmetim të programit në radio. Transmetuesi në fjalë nuk ka (posedon) borxh ndaj Agjencisë.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), leja për transmetim në radio ose televizion ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore dhe me deklaratën me shkrim ku poseduesi njofton Agjencinë se ka ndaluar transmetimin e programit në radio ose televizion. Për përfundimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio ose televizion në bazë ligjore Këshilli nuk miraton vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve nëse lejes i ka mbaruar afati sipas fuqisë ligjore (neni 85, paragrafi 2).

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, dhe në bazë të nenit 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, si dhe deklaratën me shkrim të lartpërmendur nga themeluesi/pronari i transmetuesit (e noterizuar), janë plotësuar kushtet ligjore për fshirjen e transmetuesit Shoqëria Tregtare Radiodifuzive për Radioaktivitet RADIO ZORA SHPKNJP Dellçevë nga regjistri i transmetuesve.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, deklaratën (e noterizuar), nr.y në ark.08-4808/2 datë 29.12.2023 nga themeluesi/pronar i vetëm i transmetuesit UZP nr.6037/2023 datë 28.12.2023, dhe në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale me nr.ark.01-3732/1 datë 29.7.2019 dhe konkluzionin me nr.ark.0201-125/4 datë 11.1.2024, është marrë vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.